

## Programi i ndërtimtarisë

A dëshiron të punosh me duart e tua?

A do një punë me një traditë të gjatë të zdrucktitarisë?

A dëshiron të punosh së bashku me të tjetër, por si specialist i lëmisë tënde?

A dëshiron të punosh jashtë vendit?

Në atë rast Programi i ndërtimtarisë mund të jetë për ty.

Te Programi i ndërtimtarisë të jepet mundësia që të mësosh bazat e shumë profesioneve të ndryshme që kanë të bëjnë me traditën e gjatë të zdrucktitarisë. Njëkohësisht që do të kualifikohesh në një lëmi në ndryshim e sipër. Të mësosh se si të marrësh parasysh ambientin tonë, është një pjesë e rëndësishme e kualifikimit. Punë ndërtimore dhe konstruktive në të shumtën e rasteve janë punë që bëhen në grup. Mund të zgjedhësh të specializohesh dhe të përsosesh shumë mirë për diçka që ty vetë të duket argëtuese, por do të mësosh edhe se si të bashkëpunosh me të tjerë dhe të kuptosh procesin e ndërtimtarisë në tërësi.

Lëmia e ndërtimtarisë është ndërkombëtare. Me dituri gjuhësore dhe me kuptim dhe intersim për kulturat tjera, ke mundësi të mira për të gjetur punë dhe të studiosh jashtë vendit pasi që e mbaron Programin e ndërtimtarisë.

## Të punosh apo t'i vazhdosh studimet

Nëse zgjedh Programin e ndërtimtarisë mund të kërkoesh punë menjëherë pas gjimnazit. Llojet e punëve ku mund të pranohesh varren nga drejtimi që e ke zgjedhur. Në të shumtën e rasteve të jepet mundësia që të fillimisht të punosh si çirak gjatë një viti apo gjatë disa viteve. Në atë rast të marrësh rrogë çiraku dhe do të jepet mundësia të punosh së bashku me persona që janë të punësuar në lëminë tënde që të mësosh prej tyre. Ato kanë dituri të posaçme dhe kanë përvojë pune të gjatë.

Nëse dëshiron mundesh edhe t'i vazhdosh studimet pas gjimnazit. Mund të zgjedhësh një kualifikim tek Fakulteti i profesioneve ose të studiosh në universitet apo fakultet.

## Punë ku mund të pranohesh

Pasi që e mbaron Programin e ndërtimtarisë mundesh për shembull të kërkoesh punë si punëtor në male, punëtor konstruksionesh, punëtor rrugësh, punëtor betoni, teneqexhi ndërtimin ose të ventilacionit, teknik i ndërtesave, teknik i qelqit, punëtor i dyshemeve, thumbues, muraxhi, punëtor pllakash, piktor, montues gurëzish, punëtor i mbajtësish, zduktar, monter i papafingove, monter i tavanëve ose si shitës e mallrave malore.

## Përmbajtja e Programit

Programi i ndërtimtarisë përbëhet prej kurseve. Disa kurse janë obligatorike për të gjithë ata që studiojnë në gjimnaz. Kurse e tjera janë veçanta për Programin e ndërtimtarisë. Disa nga kurse do të mund t'i zgjedhësh vetë.

Programi përbëhet prej katër drejtimeve ndërkombëtare. Kjo do të thotë se të gjithë ata që studiojnë në Programin e ndërtimit në tërë vendin mund t'i zgjedhin drejtimit. Në disa vende mund të ketë edhe më tepër drejtime që ndoshta të përshtaten ty më së miri. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve.

Drejtimet kombëtare janë:

- Konstruksion – për ty që për shembull dëshiron të punosh me rrugë, hekurudha, ura, kanalizime, parqe dhe tregje
- Njehësi shtëpi – për ty që dëshiro të specializohesh për drunjë, beton dhe mure ose në një lëmi të veçantë
- Ngjyrosje – për ty dëshiron të punosh me ngjyrosje ndërtimesh brenda dhe jashtë ndërtimit ose për ty që ke një intersim të posaçëm për ngjyrosje
- Kallorë – për ty që dëshiron të mësosh bazat e kallorë dhe që më pas ke dëshirë të mësosh kallorë ndërtimi ose kallorë ventilimesh.

## **Kontakte me tregun e punës**

Te Programi i ndërtimit do të kesh kontakte me tregun e punës që nga koha e gjimnazit. Do të keshë të paktën 15 javë kualifikim në vende të punës (APU). APU-në tënde e planifikon shkolla në bashkëpunim me vende të lira të punës aty ku banon ti. Do të jepet mundësia të keshë kontakte edhe me sipërmarrës privat edhe me kompani të mëdha ndërtimi që gjinden në shumë shtete. Kjo është një mënyrë e mirë që të krijoni kontakte të cilat mund t'i përdorësh kur do të kërkosh punë. Nëse të intereson ta bësh APU-në tënd në një vend tjetër përveç Suedisë, kjo mundësi do t'ju jepet.

## **Ardhmëri dhe punë**

Gjatë viteve të fundit ka pasur shumë nevojë për shumë punëtorë në të gjithë lëminë e ndërtimit. Edhe në ardhmëri do të ketë shumë nevojë për ata me kualifikime ndërtimi. Në Suedi ndërtohet më shumë, por jo në të gjithë vendin, vetëm në qytete më të mëdha. Për këtë shkak do të duhet të jeshë në gjendje që të shpërngulesh ose të udhëtosh në një vend tjetër për punë. Lëmia e ndërtimit është e ndryshme nga ndryshimet e tregut. Për këtë arsye është vështirë të themi se a do të jetë e lehtë apo e vështirë për ty që të pranohesh në punë pasi që e përfundon Programin e ndërtimit.